



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:091609

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05617386

C.nr. 320/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses K, me seli në Prishtinë – Distrikti në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë përfaqësuesit e autorizuar A.M dhe T.G, kundër të paditurit K (S) S nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, me bazë juridike kompensimin e dëmit material, vlera objektit të kontestit 1,328.37 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, më datën 18.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses K me seli në Prishtinë – Distrikti në Gjakovë.

II. DETYROHET i padituri K (S) S nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, që në emër të dëmit material ta kompensojë paditësen K me seli në Prishtinë – Distrikti në Gjakovë në shumën prej 1,328.37 euro me kamatë ligjore prej 8% nga data 28.07.2020 (data e parashtrimit të padisë), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET i padituri K (S) S nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë për taksën gjyqësore, paditëses K me seli në Prishtinë – Distrikti në Gjakovë, të ja paguajë shumën prej 30.00 euro në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja K me seli në Prishtinë – Distrikti në Gjakovë, më datën 28.07.2020, në këtë gjykatë ndaj të paditurit K (S) S nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, ka parashtruar padinë për kompensimin e dëmit material në shumën prej 1,328.37 euro. E njëjta, si në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare përmes të autorizuarve të saj, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, me propozimin që gjykata të bëjë shqyrtimin e provave dhe pas shqyrtimit të provave kërkesëpadinë e saj ta aprovojë në tërësi si të bazuar, me arsyetimin se me të gjitha provat e administruara nga gjykata gjatë shqyrtimit kryesor, kërkesëpadia e saj është provuar si e themeltë.

Paditësja më tej ka shtuar se dëmi në vlerën prej 1,328.37 euro është shkaktuar nga i padituri si pasojë e kryerjes së veprës penale nga neni 320 i KPRK-së. I padituri me aktgjykimin me numër P.nr.383/2016, të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, i cili është bërë i plotfuqishëm më datën 20.09.2018, është shpallur fajtor për veprën penale të kryer. Lartësia e dëmit vërtetohet në bazë të kalkulimit me numër 26304 e datës 27.11.2015, ku shihet se llogaritja e dëmit është bërë në bazë të pajisjeve elektrike të cilat i kanë qenë në momentin e konstatimit të keqpërdorimit të energjisë elektrike. Llogaritja e dëmit në mjete monetare është bërë në bazë të faturës mbi llogaritjen e dëmit DGJ, e datës 27.11.2015, e cila faturë është në pajtueshmëri me rregulloren për procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, me saktësisht neni 15 ku të paditurin nga momenti i konstatimit të keqpërdorimit të energjisë elektrike i është llogaritur në mënyre retroaktive për 12 muaj e që rezulton të jetë edhe vlera reale e kërkesëpadisë. Duke shtuar se lidhur me ekspertizën e ekspertit të elektros nuk kanë vërejtje. Me shqyrtimin dhe administrimin u konstatua dhe vërtetua se i padituri paditëses i ka shkaktuar dëm në vlere prej 1,328.37 euro, andaj i propozoi gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së ushtruar, ka ftuar të paditurin që të paraqes përgjigjen në padi, i cili si në përgjigjen në padi, po ashtu edhe në shqyrtimin kryesor, ka theksuar se e kundërshtojmë padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Duke shtura se paditësi kërkon kompensimin e dëmit material për shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të paautorizuar nga data e panjohur deri me datën 19.11.2015, gjë që paditësi duhet të vërtetoj dhe argumentoj saktë kohën dhe të paraqes në mënyrë të detajuar humbjet e shkaktuara. Paditësi si në procedurën penale, dhe në këtë rast deklaroi se këtë shfrytëzim të energjisë elektrike e ka bërë vetëm për 5 apo 6 ditë, dhe atë për shkak të nevojave urgjente, të cilat është dashur ti përfundoj për projektin e tij “Ndërtimit të shtallës për Lopë”. I njëjti ka theksuar se shtallën e ka ndërtuar dhe ska pas qare pa i pasur krejt këto mjete dhe telin e ka lidhur prej shtallës deri te shtylla. Shpenzimet e tij gjatë kësaj periudhe kanë qenë 16.65 euro për disa muaj. Gjykatës i ka propozuar që për të vërtetuar gjendjen faktike të angazhoj ekspert të elektros, me detyrë që të vërtetoj se në bazë të pajisjeve sa ka mundur të harxhohet rryma. Pajisja e cekura laktofrizi edhe pse ka qenë aty gjatë përpilimit të procesverbalit, e njëjta nuk ka punuar. Gjykatës i ka dorëzuar si provë edhe letrën e informimit me numër 3216, i datës 23.09.2013, e Ministrisë së Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ku parashihet se patjetër që këto pajise duhet të jenë në vend të ngjarjes dhe foto se në të njëjtën stalle nuk kishte lopë, si dhe si dukej stalla në atë kohë. Duke shtuar se vlera e cila është përshkruar nuk është në përputhje me sa ai paguan për energjinë mujore. Ekspertiza e përpiluar nuk e pasqyron realitetin se sa ai shpenzoi energji elektrike, ndërsa gjykatësi i propozoi që kërkesëpadinë ta refuzoj në tërësi të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës i nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 30.01.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: aktgjykimin P.nr.383/2016, i datës 25.07.2018, i plotfuqishëm nga data 20.09.2018, i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec; shkresën me id të rastit 26304, i lëshuar nga divizioni i furnizimit K; faturën me numër

DGJ15HP05489, i datës 27.15.2019; transaksionet e konsumatorit me numër 9040251; ekspertiza elektrike e punuar nga eksperti S.Gdhe e dorëzuar në këtë gjykatë me datën 29.02.2024; letër informimi i Ministrisë Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural për aplikuesin K.S me nr. të aplikacionit 11/3/2; kontratën për financimin e projekteve investuese të Zhvillimit rural 12/2013; dëftesën e pagesës së rrymës me uniref DGJ; faturën e energjisë elektrike me emër të konsumatorit lokal Kushtrim S.S dhe tre foto bardhë e zi.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Për gjykatën nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë për faktin se në bazë aktgjykimit penal P.nr.383/2016, të datës 25.07.2018 të kësaj gjykatë, i plotfuqishëm nga data 20.09.2018, vërtetohet se i padituri është shpallur fajtor dhe është dënuar me burg me kusht për kryerjen e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së. Kontestuese ndërmjet palëve ka qenë lartësia e kërkesëpadisë. Meqenëse në këtë çështje kontestimore lartësia e kërkesës ka qenë kontestuese, gjykata sipas propozimit të të paditurit ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i elektros, me detyrë që të bëjë kalkulimin e sakti të shkalles së dëmit sipas shkresave të lëndës.

Me administrimin e faturës me nr. DGJ e dt. 27.11.2015, është konstatuar se totali i humbjeve të shkaktuara sipas K është 1,328.37 euro.

Me administrimin e dokumentit me numër 26304 me emërtimin Sektori i Rikthimit të humbjeve i datës 27.11.2015, i lëshuar nga K, është konstatuar se energjia për faturim të shpenzimit të paautorizuar sipas K është 1,328.37 euro.

Me administrimin e ekspertizës të vlerësimit të dëmit të ekspertit S.G, e dorëzuar në këtë gjykatë me dt. 29.02.2024, dhe sqarimeve të tij në seancën e datës 18.04.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se kalkulimet e fuqisë të bëra nga paditësja janë të sakta, po ashtu është konstatuar faktin se konsumatori – i padituri K.S ka bërë shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike duke u lidhur direkt pa njehsor elektrik. Pra, sipas vlerësimit të ekspertit kalkulimet për keqpërdorim të energjisë elektrike nga ana e të paditurit janë në shumë prej 1,328.37 euro. Deklarimin e tij në shqyrtim kryesor gjykata e vlerësoj të hartuar dhe argumentuar mirë dhe në mënyrë profesionale, pasi që i njëjti mendim është dhënë duke u bazuar në shkresat e lëndës, andaj të njëjtin e pranoj të besueshëm dhe të njëjtit ia fali besimin në plotësi.

Sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se sipas vlerësimit të saj, në këtë çështje juridike kontestimore kemi të bëjmë me shkaktimin e dëmit material me dashje dhe atë me fajin e të paditurit. Ky faj është vërtetuar me aktgjykimet të plotfuqishme të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, ku vetë i padituri e ka pranuar fajësinë e veprës për të cilën është ngarkuar.

Sa i përket lartësisë së dëmit të shkaktuar, gjykata vendosi për kompensimin e paditësit si në II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se sipas nenit 136 par.1 të LMD-së parashihet që

*“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Lartësia e dëmit është vërtetuar edhe me ekspertizën e ekspertit të elektros dhe sa i përket vlerës së dëmit, gjykata vlerëson se me këtë shumë do të arrihej kompensimi i dëmit material të shkaktuar nën përgjegjësinë e të paditurit. Në lidhje me vendosjen sa i përket lartësisë së dëmit, gjykata pati parasysh edhe dispozitën e nenit 174 të LMD-së, sipas të cilës “Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykoj shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim”.*

Prandaj, gjykata gjatë procedurës bëri vlerësimin e të gjitha provave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, kurse në arsyetimin e aktgjykimit iu referua vetëm provave që kishin ndikim vendimtar në marrjen e vendimit si më lartë, duke u bazuar në nenin 143 par. 1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore”,* për çka ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 136 par. 1, nenit 174 si dhe nenit 382 të LMD-së, por edhe të nenit 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që i padituri t’ia kompensojë paditëses shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që i referohen taksës gjyqësore në shumë prej 30.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.320/2021, më datë 18.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale  
Adelina Çmega

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.